



Prishtinë, 07.11.2025
Kodi i ZRRE-së: V_2939_2025

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRrE/DMK_V_2752_09_25** i datës 24.09.2025;
- Ankesa e konsumatorit e datës 02.10.2025.

në seancën e mbajtur më datë 07.11.2025 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit F.M, nga Komuna e Prishtinës, si e pabazuar.
- II. **MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2752_09_25 i datës 24.09.2025.
- III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 24.09.2025 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2752_09_25 me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e konsumatorit F.M, lidhur me kontestimin e faturave të periudhës 01/02 dhe 03/2024 dhe korigjimit financiar të dt. 06.03.2025.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori F.M brenda afatit ligjor ka paraqitur Ankesë në Bordin e ZRRE-së, për këto shkaqe:

- Njehsori elektrik ka qenë në defekt dhe pas tre muajve e kanë ndërruar;
- Unë si konsumator e kam lajmëruar defektin tek KEDS;
- Kërkoj që të më largohet borxhi në vlerë prej 600 €;

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 07.11.2025 i ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 02.10.2025; Vendimin e DMK të datës 24.09.2025; Ankesën e konsumatorit në KESCO; Përgjigjen e



KESCO-s të datës 10.04.2025, Ankesën e konsumatorit në DMK të ZRrE-së të datës 14.04.2025; Fotografitë si në shkresat e lëndës; Procesverbalin e kontrollimit detal të njehsorit, me nr. 215 i dt. 20.02.2025; Procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik me nr. 0002310, i dt. 13.04.2024; Transaksionet e konsumatorit, Rrjedhën e Energjisë Elektrike dhe Listat e Leximit.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit/konsumatorit **është e pabazuar**, sepse:

Bazuar në rrjedhën e energjisë elektrike dhe analizimit të listave të leximit konstatohet se punëtorët e autorizuar të KEDS për leximin e pikave matëse kanë bërë inspektime të rregullta mujore, përveç dy periudhave, periudhës 07/2023 dhe 02/2020 kur është evidentuar nga lexuesi “Njehsori brenda, Sugjerim për zhvendosje” dhe se ne asnjë rast tjetër nuk kanë evidentuar se nuk kanë qasje në leximin e pikës matëse që vërteton se konsumatori është faturuar në shpenzime reale mujore. Mos qasja në leximin e shpenzimeve mujore nga lexuesit e KEDS-it është në kundërshtim me nenin 25 – Qasja në pronë të konsumatorit, të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, si vijon: *“Konsumatori është i obliguar që të ju lejojë qasje në pronën e tij, përfaqësuesve të Operatorit të Sistemit/Furnizuesit, për qëllim të leximit, testimit, inspektimit, instalimit, mirëmbajtjes, riparimit të matësve, kyçjeve dhe pajisjeve përkatëse ashtu si paraqitet në Nenet 28, 29 dhe 30 të Ligjit për Energji. 2. Nëse konsumatori nuk lejon qasje për leximin e pajisjeve matëse edhe pas marrjes së njoftimit me shkrim, energjia e furnizuar do të faturohet bazuar në mesataren e faturave gjatë tre (3) muajve të mëparshëm”*.

Bordi më tej i ka shqyrtuar dy procesverbalet, procesverbalin e ndërrimit të njehsorit elektrik nr. 0002310 date 13.04.2024 si dhe procesverbalin e kontrollimit detal nr.915 të datës 20.02.2025 me të cilin vërtetohet se konsumatori me date 13.04.2024 i është larguar nga matja njehsori elektrik nr. 7911160 me gjendje të shpenzimeve TL=15952 kWh dhe TU=83959 kWh dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 40129888 me gjendje të shpenzimeve TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh. Në procesverbalin e kontrollimit detal të njehsorit elektrik nr.915 të datës 20.02.2025 punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë evidentuar se: Njehsori elektrik pllombat i ka në rregull, nga ana e jashtme njehsori dëmtime nuk ka si dhe në brendi të njehsorit komisioni nuk ka vërejtur ndonjë parregullsi. Bazuar në të dhënat teknike të evidentuara në procesverbal për njehsorin elektrik nr. 7911160 vërtetohet se gjendja e shpenzimeve të regjistruar në njehsorë është TL=16734 kWh dhe TU=83958 kWh, gjendje e cila ndryshon nga gjendja e shpenzimeve të evidentuar në procesverbalin e ndërrimit të njehsorit elektrik nr. 0002310 date 13.04.2024, përkatësisht ndërron gjendja në Tarifën e lartë prej 782 kWh. Bordi konstaton se ekipi i KEDS-it me rastin e ndërrimit të njehsorit elektrik date 13.04.2024 ka bërë vetëm përshkrimin e gjendjes së lexuar në periudhën 03/2024 duke mos evidentuar saktë gjendjen e shpenzimeve me rastin e ndërrimit. Në fotografinë e njehsorit elektrik nr. 7911160 vërtetohet se gjendja e shpenzimeve pas ndërrimit është TL=16734 kWh dhe TU=83958 kWh dhe jo TL=15952 kWh dhe TU=83959 kWh.

Po ashtu, Bordi i ka shqyrtuar faturat nr. 01240DPR-23911, nr. 02240DPR-23911 dhe nr. 03240DPR-23911 dhe konstaton se konsumatori për këto tri periudha është faturuar vetëm me shpenzime të regjistruara në tarifën e lartë/TL. Bazuar në analizën e rrjedhës së energjisë elektrike vihet re se konsumatori deri në periudhën 12/2023 ka pasur të regjistruar shpenzime në dy tarifatat kurse nga



periudha 01-03/2024 vetëm ne tarifën e lartë. Bordi i ka analizuar edhe shpenzimet e konsumatorit me njehsorin e ri elektrik nr. 40129888 dhe konstaton se mesatarja e shpenzimeve të konsumatorit për periudhën e njëjtë të mëvonshme (01-03/2025) në dy tarifat është: **TL=64%** dhe **TU=36 %**. Duke pasur parasysh mesataren e shpenzimeve me njehsorin e ri, ka bërë rishpërndarjen e kWh të faturuar në faturat 01/02/03/2024 dhe konstaton se konsumatorit nuk i takon korrëgjim financiar.

Në të njëjtën kohë, është shqyrtuar edhe korrëgjimi plotësues financiar nr. 107074DPR-23911 të datës 06.03.2025, të bërë nga Departamenti i faturimit në KESCO në vlerë prej 51.77€, në të cilin është evidentuar si vijon: *“Faturim i kWh për periudhën 04/2024 duke u bazuar në Protokoli i kontrollimit detal me nr seri 02/915 dt. 20.02.2025 A1=16734 dhe A2=83958”*, dhe ka gjetur se, ky korrëgjim është i saktë, pasi që përfshin ndryshimin e kWh nga leximi i periudhës 03/2024 dhe date 13.04.2024 kur edhe është ndërruar njehsori. Bordi po ashtu edhe në këtë rast ka bërë rishpërndarjen e kWh për TL=64% dhe TU=36 % dhe konstaton se konsumatorit nuk i takon korrëgjim financiar.

Tutje, duke u bazuar në nenin 5 – Furnizimi me Energji elektrike – të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, *“të gjithë konsumatorët e kanë për obligim që të paguajnë për energjinë elektrike të shfrytëzuar sipas kontratës për furnizim me energji të lidhur me furnizuesin e energjisë, si dhe për tarifat për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja”*, andaj konsumatori e ka për obligim që të paguaj energjinë elektrike të cilën e ka shpenzuar.

Bordi i ZRRE pas analizave të bëra dëshmime dhe argumenteve të paraqitura nga palët si dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, Rregullën për Shkycjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë, transaksionet e konsumatorit, Listat e leximit, Rrjedhën e energjisë elektrike, si dhe dokumentet e tjera si në shkresat e lëndës, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s,



- Konsumatorit **F.M** dhe
- Arkivit të ZRRE-së.